

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr.236 date 10.5.93

PER ADMINISTRIMIN E FURNIZIMIT ME UJE PER PERDORUESIT
FAMILJAR DHE JO FAMILJAR

Me propozimin e Ministrise se Ndertimit , Strehimit dhe Rregullimit te Territorit ,Keshilli i Ministrave

V E N D O S I

1. Furnizimin me uje te pijshem teknologjik nga ndermarrja e Ujesjellesit per konsumatorët privat dhe shtetëror qe lidhen ndërmjet paleve.
2. Konsumatorët jofamiljar shtetëror ose privat qe furnizohen me uje nga keto Ndermarrje , te sigurojne dhe te vendosin me shpenzimet e tyre matesit e ujit. Ndermarrjet e ujesjellesit percaktojne kapacitetin , tipin dhe projektin e vendosjes se tyre.Me kalimin e ketij afati Ndermarrjet e Ujesjellesit te nderpresin furnizimin me uje te tyre.Pasi konsumatori vendos matesin sipas projektit te miratuar nga Ndermarrja e Ujesjellesit,mbahet nje proces verbal i perbashket.
3. Konsumatorët jofamiljare , shtetërore ose privat , qe furnizohen me uje te pijshem, i sigurojne , administrojne dhe ruajne vete matesit e ujit. Ne rast demtimi konsumatori jofamiljare duhet te njoftoje me shkrim Ndermarrjen e ujesjellesit dhe te marre masa per ta zevendesuar matesin e ujit , brenda 30 diteve.Pagesa e konsumit te ujit per kete periudhe behet ne baze te normave te konsumit mesatar mujor te konsumatorit.Nese ndermarrja e Ujesjellesit nuk njoftohet per demtimin e matesit ose matesi nuk vendoset brenda afatit te caktuar konsumatori (jofamiljar) detyrohet te paguaje konsumin mesatar te ujit me 5- fishin e çmimit.
4. Ne rast se konsumatori nuk paguan detyrimin qe ka ndaj Ndermarrjes se Ujesjellesit ne baze te kontrates per furnizimin me uje ,detyrohet te paguaje nje shtese prej 5 % te vleres se konsumit te ujit per çdo dite vonese.Nese pagesa nuk kryhet per 30 dite ,konsumatori detyrohet te paguaje gjithë sasine e ujit te konsumuar me 5-fishin e çmimit.Me kalimin e ketij afati Ndermarrja e Ujesjellesit nderpret furnizimin me uje.
5. Nderhyrjet ne sistemin e ujesjellesit , lidhjet e pamiratuara nga ndermarrja e Ujesjellesit dhe demtimet e çdo lloji denohen si kundravajtje administrative me

gjobe deri ne 10 mije leke per konsumatoret jofamiljar si dhe me nderprerjen e furnizimit me uje .Vendimet e denimit jepen nga Inspektori i kontrollit te ujit dhe nga punonjesi i autorizuar nga drejtori i Ndermarrjes se ujesjellesit.Kundravajtesi detyrohet te paguaje dhe shpenzimet e nevojshme per sjelljen e pjeses se demtuar ne gjendjen e mepareshme.

6. Kunder vendimit te denimit mund te behet ankim me shkrim brenda 10 diteve nga shpallja ose njoftimi i tij ,te drejtori i ndermarrjes se Ujesjellesit akti i te cilit eshte i formes se prere.
7. Per rastet e parashikuara ne pikat 2, 4 dhe 5 te ketij vendimi , kur Ndermarrja e Ujesjellesit nderpret furnizimin me uje , kontrata ndermjet paleve quhet e zgjidhur. Me kerkesen e konsumatorit ndermarrja e ujesjellesit ben rilidhjen e furnizimit me uje brenda 30 diteve pasi konsumatori te kete paguar detyrimet ndaj ndermarrjes dhe te gjitha shpenzimet per nderprerjen dhe rilidhjen e furnizimit me uje.Pasi te jete bere rilidhja , konsumatori lidh kontrate te re me Ndermarrjen e Ujesjellesit.
8. Ngarkohet Ministria e Ndertimit, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit , organet e pushtetit lokal dhe Ndermarrja e Ujesjellesit per hartimin e programit per plotesimin me mates uji te konsumatoreve jofamiljare.
9. Te gjitha aktet nenligjore qe bien ne kundershtrim me kete Vendim shfuqizohen. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
- ALEKSANDER MEKSI -

Nr.Prot.2001/1
Date 25.5.1993